

BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 12 prill 2013

**Programi Kulturor i BE-së – projektet e përkthimeve letrare
(Panairi i Librit në Shkup)**

Fjalim
Ambasadori Aivo Orav
Shef i Delegacionit të BE

**E nderuara Ministreshë zj. Kançeska-Milevska,
E nderuara zj. Prentovska,
Zonja dhe zotërinj,**

Kam nderin që me rastin e vitit të 25 me radhë të Panairit të Librit, ne organizojmë këtë eveniment dhe kemi mundësinë të promovojmë beneficionet e Programit Kulturor të Bashkimit Evropian. Gjithashtu kam nderin të jem në shoqërinë e diskutuesve dhe pjesëmarrësve të mirënjohur në panelin e diskutimit, i cili më vonë do të shqyrtojë perspektivat e "Letërsisë evropiane – sot dhe nesër."

Kur mësova se 163 tituj janë përkthyer me mbështetjen e Bashkimit, më bën të ndjehem shumë krenar. Përmes letërsisë të gjithë jemi të bashkuar me shumëllojshmërinë tonë kulturore.

Pas këtij suksesi ne mundohemi të krijojmë themelimin e një çmimi për përkthyesit e rinj.

Programi Kulturor i BE-së është shtytës i fuqishëm për zhvillimin e individëve dhe institucioneve. Ai konsiderohet si bllok ndërtimi për zhvillimin njerëzor dhe institucional dhe një nga instrumentet më të fuqishme për mundësitë gjithnjë e më të mëdha që u ofrohen qytetarëve nga Bashkimi Evropian.

BE-ja i kushton vëmendje të veçantë Programit Kulturor. Prandaj programi i ardhshëm Kulturor 2014-2020 – Evropa

Kreative – do të harmonizohet me strategjinë e përgjithëshme të nisur nga Agjenda Evropiane për Kulturë, dhe do të përfshihet në vizionin e përgjithshëm të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfshirës të caktuar nga strategjia Evropa 2020. Buxheti i propozuar për periudhën 2014-2020 arrin vlerën prej 1.6 miliardë euro për sektorin kulturor.

Zonja dhe zotërinj,

Jam i bindur se shumë operatorë kulturorë të vendit do ë vazhdojnë të zbatojnë suksesshëm projektet e financuara kulturore. Të gjithëve ju dëshiroj shumë sukses në këtë proces i cili ndonjëherë është shumë i ndërlikuar.

Ju falnderit për vëmendjen.